



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
eëë.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300731/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Kurbin.

Drejtuar: z. Shkëlzen METUSHI
Shef i Komisarimit të Policisë Kurbin

KURBIN

Për dijëni: z. Alfred ELEZI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

LEZHË

Për dijëni: Drejtues Madhor Z. Mehmet RRUMBULLAKU
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisaratin e Policisë Kurbin nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Kurbin, në datën 31.08.2023, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe znj. Lindita Dedgjoni, me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, "Për miratimin e procedurës standarde, rregullave teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Kurbin, z. Dritan Metaj, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Pasi u njohën me qëllimin e inspektimit, shefi i Komisarariatit dhe ai i Rendit, informuan grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë së këtij Komisarariatit për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e përgjithshëm të nevojshëm, vijoi takimin me punonjësën përgjegjës të dhomave të shoqërimit, i cili na u bashkua gjatë evidentimit të kushteve të ambienteve të Komisarariatit të Policisë Kurbin.

Theksojmë se, punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kurbin me të cilët kontaktuam, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit.

U inspektuan ambientet e shoqërimit dhe u verifikua dokumentacioni përkatës, në të cilin pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar.

Në Komisarariatit të Policisë Kurbin, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022, rezultoi se:¹

- Ishte zbatuar rekomandimi, për mirëmbajtjen e kushteve higjieno-sanitare dhe të pastërtisë në ambientet e Komisarariatit të Policisë, si dhe për lyerjen dhe dezinfektimin e vazhdueshëm të tyre.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për gjetjen e fondeve përkatëse për ndërtimin/rikonstrukcionin e plotë të godinës së Komisarariatit të Policisë Kurbin, sipas kritereve të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për krijimin e ambienteve të përshtatshme dhe bashkëkohore për shtetasit e ndaluar apo shoqëruar, në konflikt me ligjin.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e zyrës së intervistimit, ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

¹ Dërguar rekomandimi për inspektimin e bërë në Komisarariatit të Policisë Kurbin, K4/I 12-2 prot, datë 08.07.2022.

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe meshkuj, si dhe të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Kurbin.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, u evidentua gjithashtu, dhe një problematikë në lidhje me godinën e Komisarariatit të Policisë Kurbin, e cila për shkak të dëmtimeve në strukturat e jashtme dhe të brendshme të saj nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, paraqiste mjaft probleme, ku një pjesë e e godinës ishte jashtë funksionit. Gjithashtu, u evidentua se struktura mbajtëse e godinës, muret dhe soleta janë shumë të dëmtuara dhe janë në prag të shembjes, dhe për këtë arsye administrata ishte zhvendosur në katin e parë të këtij institucioni, duke punuar në kushtet e rrezikshmërisë për jetën dhe shëndetin e punonjësve të Komisarariatit të Policisë Kurbin.

Po ashtu, shefi i Komisarariatit na informoi se edhe pse është bërë kërkesë për investim në mënyrë të vazhdueshme drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, për gjendjen në cilën ndodhet institucioni, edhe pse kanë ardhur specialistët nga Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit, ku kanë bërë dhe një raport konstatimi në lidhje me dëmtimet e godinës deri më sot nuk është bërë asgjë.

Institucioni i Avokatit Popullit kërkon marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe institucionet e tjera përgjegjëse për mbylljen e Komisarariatit të Policisë Kurbin dhe zhvendosjen e administratës në një godinë tjetër për të qenë sa më funksionale në ofrimin e kushteve të përshtatshme të stafit të këtij institucioni në shërbim të qytetarit, por dhe për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, deri në ndërtimin apo rikonstruksionin e plotë të kësaj godine.

Grupi i inspeksionit, i kushtoi rëndësi të veçantë plotësimit të kushteve të jetesës, të dhomave të shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Kurbin, sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ndërtimin e tyre, si dhe trajtimin e shtetasve në këto mjedise, në bazë të akteve ligjore dhe akteve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e tyre.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarariatit të Policisë së Kurbin, ambienti i shoqërimit në tërësi ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Mjedisi i shoqërimit ndodhet në një ndërtesë më vete nga godina kryesore e Komisarariatit. Kjo ndërtesë ishte në gjendje të mirë. Ambienti i shoqërimit përbëhet nga 3 (tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete, 1 (një) dhomë shoqërimi për personat e rritur, 1 (një) dhomë për femra dhe 1 (një) dhomë për të mitur².

² Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Dhomat e shoqërimit kishin hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme dhe ishin të pajisura me tavolina dhe me karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4m x 3m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të treja dhomat gjithashtu kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dyert ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t'u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi të 3 dhomat ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në këto ambiente nuk kishte sistem ngrohjeje/ftohjeje.

Dhomat e shoqërimit **nuk** ishin të pajisura me tualete brenda apo ngjitur me to. Të shoqëruarit përdornin tualetin, i cili përdorej edhe nga punonjësit e policisë të këtij Komisariati. Në korridorin e dhomave të shoqërimit ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për vëzhgimin e veprimeve, që kryheshin nga punonjësit e policisë me të shoqëruarit.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në lidhje me zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë kryerjes së veprimeve me personat e shoqëruar, në Komisaratin e Policisë Kurbin, nuk kishte dhoma (zyra) për marrjen në pyetje/intervistimin e këtyre personave³. Ndërsa për të miturit në konflikt me ligjin ishte krijuar një ambient i veçantë për marrjen në pyetje dhe intervistimin e tyre.

Në Komisaratin e Policisë Kurbin, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.08.2023, ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **156** persona, ku saktësisht **144** shtetas madhorë, **10** shtetas të mitur dhe **2** shtetase femra të shoqëruara në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe nenin 112/1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Në momentin e inspektimit, nuk kishte asnjë shtetas në dhomat e shoqërimit.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë Komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe nenin 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të Komisarariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisaratin e Policisë Kurbin nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë të Lezhës.

³ Kreu VI, pika 4/e e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin, u konstatua se, regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në Komisarlatin e Policisë Kurbin, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁴.

Në këtë Komisarlat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e arrestimeve dhe ndalimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi. Në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Nga inspektimi, u konstatua se Komisarlati i Policisë Kurbin, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2022 ishin të shoqëruar **10** të mitur në konflikt me ligjin⁵.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarlat **nuk** administrohej regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Sa më sipër përbën cënim të standardit të parashikuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019 “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, përkatësisht në Kreun XV “Procedurat për evidentimin dhe trajtimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar”, pika 5.1, gërma “c”⁶.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe

⁴ Kreu VII i procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

⁵ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

⁶ Punonjësi i policisë që merr ankesë/kërkesën e pasqyron atë në regjistrin e ankesë/kërkesave sipas rubrikave përkatëse, si dhe nënshkruan për këtë gjë në rubrikën përkatëse të regjistrit.

instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar⁷.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve kombëtare e ndërkombëtare⁸, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Në lidhje me intervistimin/marrjen në pyetje të personave të mitur, sikurse e përmendëm edhe në rekomandimin e mëparshëm, ishte krijuar një ambient më vete, brenda godinës së Komisarariatit. Ky ambient përbëhej nga 2 dhoma të ndara më vete, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor dhe avokatit mbrojtës, si dhe me orenditë për punën që kryejnë specialistët e policisë. Stafi i policisë që punonte në Njësinë për Intervistimin e të Miturve, përbëhej nga 1 specialist policie, i cili ishte trajnuar për këtë qëllim, por ambientet e njësisë nuk janë në funksion për shkak të godinës së Komisarariatit shumë të dëmtuar, dhe ishin të kyçura me çelës.

Nga monitorimi që iu bë zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Në çdo rast monitorimit filmik i procedurave të intervistimit është mënyra me efikase për menjanimin e dhunës psikologjike për të shoqëruarit, i cili mbetet një fenomen i denoncuar vazhimisht nga personat e ndaluar. Sa më sipër, është evidentuar nga disa raporte të CPT për Shqipërinë.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

⁷ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

Konsulto:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

⁸ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte afishuar në zyrën e përgjegjës të zyrës së informacionit. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të qytetit të Laçit, si dhe Bashkinë e këtij qyteti, por stafi i institucionit e ngriti si shqetësim vonesën e psikologut nga 1 orë deri 3 orë për shkak të kryerjes së detyrës pranë institucionit ku ata punojnë. Gjithashtu, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë ka mungesë të psikologut në organikë për shkak të dhënies së dorëheqjes së tij nga funksioni në këtë institucion. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar, u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kurbin ishte zhvilluar konform ligjit.

Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga institucioni përgjegjës emërimin e psikologut në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, për të ofruar menjëherë mbështetje për trajtimin e problematikave të rasteve të personave të mitur në konflikt me ligjin që në orën e parë të shoqërimit në ambientet e privimit të lirisë.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqisnin probleme shëndetësore, ata i shoqëronin në Qendrën Shëndetësore Laç, për të marrë ndihmën mjekësore.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në ambientet e dhomave të shoqërimit të këtij Komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për mbylljen e godinës ekzistuese në Komisariatin e Policisë Kurbin, pasi ajo nuk plotëson kushtet dhe kriteret që garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të tyre, të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, dhe zhvendosjen e administratës në një godinë tjetër për të qenë sa më funksionale në ofrimin e kushteve të përshtatshme të stafit të këtij institucioni në shërbim të qytetarit, por dhe për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, deri në ndërtimin apo rikonstruksionin e plotë të kësaj godine.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Kurbin, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.

Deri në realiziminë sa më sipër, të zbatohen këto rekomandime:

3. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e pozicionit të psikologut sipas parashikimeve në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, për të ofruar menjëherë mbështetje për trajtimin e problematikave të rasteve të personave të mitur në konflikt me ligjin që në orën e parë të shoqërimit në ambientet e privimit të lirisë.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrës së intervistimit, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
5. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe meshkuj, si dhe të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Kurbin.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në Komisariatin e Policisë Kurbin.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

AHMET PRENÇI